

Nr. Prot. 120/B/19

VENDIM Nr. 1471

Për

Fillimin e procesit të Konsultimit Publik të

“Draft Rregullore për Oferten Referente për Qasjen e Hapur në Lakun Lokal dhe Bitstream”

Në mbështetje të nenit 1, nenit 3, paragrafët 1) dhe 2), nenit 9, paragrafi 3.3), nenit 10, paragrafi 4), nenit 33, nenit 34, nenti 36, neni 37, nenit 79 paragrafët 1) dhe 2) dhe nenit 82, paragrafët 1) dhe 3) të Ligjit për Komunikimet Elektronike Nr. 04/L-109 (*tutje referuar si – Ligji ose LKE*) dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si – Autoriteti ose ARKEP*), Bordi i Autoritetit i përbërë nga:

- | | |
|-----------------------|---------|
| 1) z. Kreshnik Gashi, | Kryetar |
| 2) z. Nijazi Ademaj, | Anëtar |
| 3) z. Hazir Hajdari, | Anëtar |
| 4) z. Bahri Anadolli, | Anëtar |

në mbledhjen e 51-të me radhë të mbajtur më datë 22 Nëntor 2019, pas shqyrtimit të draft Rregullore për Sërbimin e Interkoneksionit në rrjetat e komunikimeve elektronike dhe rekomandimit të Departamentit të Komunikimeve Elektronike (DKE) dhe Departamentit Ligjor (DL), vendosi si më poshtë:

V E N D I M

- I. Miratohet fillimi i Konsultimit Publik të dokumentit ‘**Draft Rregullorja për Oferten Referente për Qasjen e Hapur në Lakun Lokal dhe Bitstream**’.
- II. Procesi i konsultimit publik fillon më datë **10 Dhjetor, 2019** dhe përfundon më **24 Dhjetor, 2019**.
- III. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Neni 1 i Ligjit specifikon qëllimin e Ligjit si në vijim:

“Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i aktiviteteve të komunikimeve elektronike bazuar në parimin e neutralitetit teknologjik dhe kornizën rregullatore të BE-së për komunikimet elektronike, duke promovuar konkurrencën dhe infrastrukturën efikase në komunikimet elektronike, si dhe garantimin e shërbimeve të duhura e të përshtatshme në territorin e Republikës së Kosovës.”

Ligji, respektivisht neni 10, paragrafët 4) përcakton se Autoriteti: “Miraton legjislacionin sekondar lidhur me këtë ligj, të cilat janë në kompetencë të Autoritetit, mbështetur në dispozitat e këtij ligji.”

Neni 82 i Ligjit përkufizon se Autoriteti gjatë aprovimit të akteve normative duhet t’i publikoj ato në pajtim me kushtet dhe procedurat e vendosura nga Autoriteti, duke ua ofruar mundësinë personave të interesuar që në afat të arsyeshëm kohor të shprehin pikëpamjet e tyre.

Rregullorja për ofertën referuese për qasjen e hapur në lakun lokal dhe qasjen në bitstream përcakton:

- Procedurat dhe afatet e fundit për ndërmarrjen e komunikimeve elektronike me fuqi të konsiderueshme në treg, në të cilat Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (këtej e tutje Rregullatori) ka obliguar për shtjellimin dhe publikimin e ofertës referuese për qasje të hapur në lakun lokal apo qasje në bitstream.
- Kërkesat për publikimin e informacioneve dhe informacionet që duhet të përfshihen në ofertën referuese, si dhe niveli i detajeve të këtyre informacioneve.

Andaj, Bordi i Autoritetit ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit.

Prishtinë, 10/12/2019

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Nijazi Ademaj,
Hazir Hajdari,
Bahri Anadolli,

Aktvendimi i dërgohet:

- Ofruesve të shërbimeve të Komunikimeve Elektronike
- Departamentit të Komunikimeve Elektronike,
- Departamentit Ligjor,
- Arkivës së Autoritetit.